

COMMUNICATING EUROPE

Membership Negotiations

Të rinjtë janë konsideruar gjithmonë forca lëvizëse e së ardhmes së çdo ekonomie. Gjatë periudhës së gjatë të tranzicionit, në rajonin e Shqipërisë janë zhvilluar shumë iniciativa për të promovuar fuqizimin, punësimin, zhvillimin e aftësive, si dhe kulturën e sipërmarrjes në kulturën e përgjithshme të të rinjve. [Një element dallues për Shqipërinë është mosha e re që e karakterizon. Shqipëria është një nga vendet më të reja në Evropë, me një moshë mesatare 36.2 vjeç dhe ku 42% e popullsisë së saj është midis moshës 25-54 vjeç.](#) Ky element përbën dhe një faktor kyç në zhvillimin e politikave me fokus të rinjtë, nxitjen e sipërmarrjeve të nisura nga të rinj, si startup-et, si dhe çdo iniciativë tjetër inovative që çon në zhvillimin e një ekosistemi mundësues e mbështetës për ta.

Ka ardhur koha që shoqëria shqiptare të përqendrohet në inovacion, dixhitalizim dhe promovimin e krijimit të sipërmarrjeve të reja, si startup-e apo NVM (Ndërmarrje të Vogla e të Mesme) inovative. Në këtë kuadër, krijimi i startup-eve si një zgjedhje praktike karriere për brezat e rinj mund të jetë një zgjidhje e shkëlqyeshme jo vetëm drejt punësimit të të rinjve, por edhe në drejtim të diversifikimit të tregut drejt produkteve dhe shërbimeve më dixhitale inovative si dhe do ndikonte në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Është e rëndësishme të zhvillohen dhe të përdoren aftësitë dixhitale për punësim dhe sipërmarrje. Duhet që shoqëria shqiptare të jetë përgatitur dhe në gjendje të parashikojë sot se cilat aftësi do të

NXITJA E POLITIKAVE PËR TË RINJTË NË KUADËR TË INTEGRIMIT EVROPIAN, PËRMES ZHVILLIMIT TË EKOSISTEMIT TË STARTUP-EVE DHE SIPËRMARRJES

EU Policy Hub

nevojiten në të ardhmen, në mënyrë që të trajnojnë të rinjtë sot në përputhje me nevojat e nesërme të tregut të punës.

Papunësia tek të rinjtë në Shqipëri

Në vitin 2019, shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç ishte 27,2 % (27,8 % për meshkujt dhe 26,3 % për femrat). Krahasuar me vitin pararendës, shkalla e papunësisë së të rinjve ka rënë me 1,1 përqind. [Të dhënat e po këtij viti tregojnë se të rinjtë e moshës 15-29 vjeç të cilët nuk janë të punësuar dhe nuk janë duke ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional përbëjnë 28,9 % të të rinjve në përgjithësi.](#) Papunësia e të rinjve sjell probleme serioze në vend. Disa prej problemeve kryesore me të cilat përballen të rinjtë në ditët e sotme janë: vështirësia në gjetjen e një pune, mungesa e të ardhurave, mungesa e përvojës së punës, çështjet sociale, humbja e besimit kur nuk gjejnë punë për një periudhë të gjatë kohore ose një punë që i përshtatet formimit të tyre arsimor, etj. Të rinjtë janë mosha më e prekur ndaj luhatjeve ekonomike dhe mjedisore dhe gjithashtu kanë vuajtur më së shumti nga pasojat e krizës ekonomike për sa i përket papunësisë dhe migrimit ndër vite. Kjo përforcohet edhe më shumë në situatën e pandemisë ku ndodhemi aktualisht. Si rrjedhim, kthimi i vëmendjes tek nxitja e sipërmarrjeve e startup-eve inovative gjatë kësaj periudhe të vështirë, mund të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e kësaj situatë

në favor jo vetëm të të rinjve por dhe të ekonomisë së vendit në tërësi. Kjo do të sillte jo vetëm rritjen e numrit të punësuarve dhe të vetëpunësuarve ndër radhët e të rinjve, por mund të ishte dhe një zgjidhje për të prezantuar elemente inovative tek sipërmarrjet aktuale duke bërë të mundur "martesa" midis bizneseve të konsoliduara tradicionale dhe startup-eve inovative.

Rritja ekonomike përmes zhvillimit të ekosistemit të Startup-eve

Duke marrë në konsideratë që vëmendja e pjesës më të madhe të vendeve të botës, në vitet e fundit po zhvendoset drejt inovacionit, sipërmarrjes dhe krijimit të ekosistemeve që promovojnë startup-et, Shqipëria po zhvillon një sërë politikash që do të nxisin rritjen ekonomike dhe do të përshpejtojnë zhvillimin e ekosistemit të startup-eve nëpërmjet një qasjeje shumë më të strukturuar që i përshtatet dhe mjedisit lokal. [Synimi i këtyre politikave është dhe zhvillimi i klimës sipërmarrëse për të bërë të mundur rritjen e numrit të sipërmarrjeve të reja me potencial për t'u zhvilluar në ndërmarrje të vogla dhe të mesme \(NVM\) ose kompani gjithmonë e në rritje.](#)

Çfarë është një Start-up?

Steve Blank i përcakton startup-et si "organizata të përkohshme në kërkim të një modeli biznesi të suksesshëm që mund të ri-përsëritet". Ndërsa sipas Startup Genome, një Ekosistem Startup-esh është një grup i përbashkët burimesh (politikëbërës, akseleratorë, inkubatorë, hapësira bashkëpunimi, institucione arsimore dhe biznese apo grupe financimi), të vendosura zakonisht në një rreze prej 60 milje (100 kilometra) [rreth një pike qendrore në një rajon të caktuar.](#)

Duke qenë se Shqipëria është një vend që aspirojnë të anëtarësohet në Bashkimin Evropian, zhvillimi i instrumentave dhe politikave që nxisin sipërmarrjen e re, sidomos tek të rinjtë, mund të rezultojë një hap i rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të inovacionit në vend, rritjes së nivelit të punësimit tek të rinjtë, si dhe rritjes ekonomike të vendit. Më shumë vende pune dhe mundësi për ngritjen e bizneseve të reja fitimprurëse mund të sigurojnë që më shumë të rinj shqiptarë të qëndrojnë e punojnë në vendin e tyre e mos të aspirojnë për të ikur nga vendi i tyre në kërkim të një jetë më të mirë në

vende të Bashkimit Evropian, duke inkurajuar në të njëjtën kohë dhe emigrantët për t'u kthyer në vendlindjen e tyre.

[Shifrat tregojnë se shumica e aktiviteteve të biznesit në Shqipëri është në shkallë mikro dhe përqëndrohet në sektorë tradicionale siç janë bujqësia, pylltaria, peshkimi, akomodimi dhe shërbimi ushqimor dhe tregtia.](#) Nga regjistrimet rezultojnë se shumica janë ndërmarrje të vogla, ku 5,767 e tyre (në 2017) ishin në bujqësi, pylltari dhe peshkim, 6,237 në tregti dhe 4,268 në akomodimin dhe shërbime ushqimore. Gjithashtu, statistikat tregojnë se në një periudhë afatgjatë potenciali i rritjes së bizneseve nuk është i kënaqshëm: [Përafërsisht, 90% e të gjitha kompanive të regjistruara mbeten me madhësi mikro \(1-4 punonjës\), duke mos u zgjeruar me aktivitete biznesi inovative dhe pa u orientuar drejt rritjes dhe zgjerimit.](#) (Instat, 2017)

[Ekosistemi i startup-eve në Shqipëri është në fazat e para të zhvillimit. Ai po zhvillohet gradualisht dhe angazhimi i sipërmarrësve të rinj duket shumë premtues, duke kontribuar me ide biznesi shumë inovative.](#) Startup-et krijojnë vende pune në ata sektorë të ekonomisë që janë të orientuar drejt së ardhmes dhe sjellin një impuls pro-aktiv në ekonomi përmes mënyrës së tyre konkurruese dhe dinamike të funksionimit.

Qeveria shqiptare ka filluar ndërmarrjen e hapave të parë në këtë drejtim. Në këtë kuadër ka filluar hartimi i një Programi Kombëtar në lidhje me zhvillimin e ekosistemit të startup-eve dhe të inovacionit në vend. Ky Program ka për qëllim përmirësimin e ngritjen të një ekosistemi të shëndoshë të startup-eve dhe nxitjen e krijimit të sipërmarrjeve inovative në Shqipëri.

Gjithsesi, duhet patur parasysh se përmirësimi dhe rritja e ekosistemit të startup-eve është një përpjekje afatgjatë që synon krijimin e një shoqërie të bazuar në njohuri dhe informacion rreth inovacionit, teknologjisë dhe sipërmarrjes, duke përfshirë të gjitha palët e interesit. Si rrjedhim, është e rëndësishme që të kryhen përpjekje për të forcuar sinergjitë duke bërë të mundur koordinimin e suksesshëm mes politikëbërësve, donatorëve, shoqërisë civile, mediave, institucioneve financiare, universiteteve dhe sektorit privat. Një koordinim i suksesshëm i të gjithë aktorëve të ekosistemit të

start-ups, privatë dhe publikë, do të sigurojnë një përshpejtim dhe gjallërim të ekosistemit, duke nxitur një komunitet aktiv, të orientuar drejt veprimit.

Pra, që ekosistemi i startup-eve të jetë i qëndrueshëm dhe në rritje në planin afatgjatë, duhet të ketë bashkëpunim të vazhdueshëm midis aktorëve të ndryshëm të ekosistemit, ku barra kryesore bie mbi sektorin privat.

Në të njëjtën kohë, hapa po ndërmerren dhe në fushën rregullatore. Shqipëria ende nuk ka një ligj specifik të dedikuar për startup-et dhe nuk ekziston asnjë strategji kombëtare në këtë fushë. Qeveria ka filluar përpjekjet për krijimin e një kuadri të favorshëm ligjor për startup-et në Shqipëri. Në këtë kuadër, është hartuar projektligji **"Për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve inovative"**, i cili ka si qëllim kryesor të ndihmojë në sigurimin e stimujve për startup-et e reja inovative dhe ato ekzistuese, në mënyrë që të arrijnë të lulëzojnë dhe të mund të kthehen në NVM të suksesshme. Ky projektligj i cili është aktualisht duke iu nënshtruar procesit të konsultimit publik, në një këndvështrim të përgjithshëm synon të krijojë një kuadër rregullator dhe institucional, i cili do të jetë i favorshëm për krijimin dhe zhvillimin e Startup-eve Inovative në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Më konkretisht synon nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve, modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë të ekonomisë.

Në këtë projekt ligj përcaktohen të gjitha organet shtetërore, rregullat dhe procedurat, si dhe masat mbështetëse që do të zbatohen për certifikimin dhe mbështetjen e Startup-eve Inovative si dhe krijimin e një eko-sistemi të favorshëm për to në Republikën e Shqipërisë.

Krijimi i këtij projektligji do të sjellë lehtësi të shtuara për ekosistemin e startup-eve në Shqipëri dhe më konkretisht disa prej tyre janë si më poshtë:

- Në fazën fillestare të zhvillimit startup-et përfitojnë shërbime konsulence dhe informacioni, inkubimi, mentorimi dhe mbështetje të projekt idesë
- Startup-et Inovative, të cilat janë certifikuar dhe janë regjistruar në regjistrin tregtar, duke plotësuar

kriteret dhe duke zbatuar procedurat e përcaktuara nga ky ligj, përgjatë periudhës së inkubimit, kanë të drejtën të përfitojnë disa masa mbështetëse sic është përjashtimi nga pagesa e disa taksave vendore, etj.

Ekosistemi i startup-eve në Shqipëri: Sfidat & Mundësitë

Ekosistemi shqiptar ofron një sërë faktorësh pozitivë mbi të cilët mund të ndërtohet ekosistemi i startup-eve. Nisur nga vlerësimet e shumë profesionistëve si dhe gjetjet e studimeve të ndryshme, Shqipëria konsiderohet si një vend "në zhvillim", që ka shumë potencial të papërdorur për të përmirësuar ekosistemin e startup-eve. Përveç gatishmërisë së komunitetit të startup-eve dhe qeverisë shqiptare për të ofruar ndihmën e tyre në mënyrë që të zhvillojnë më tej ekosistemin, stimuj të tjerë në vazhdimësi duhet të merren në konsideratë. [Sic tregojnë shifrat, Shqipëria ka një popullsi relativisht të re dhe gjithashtu një numër të lartë të të diplomuarve në universitete, \(rreth 30,000 të diplomuar çdo vit\) gjë që dëshmon se ekziston një përqindje e lartë e të rinjve që kërkojnë punësim apo vetë-punësim.](#) Nga ana tjetër, programet e projektet për mbështetjen e startup-eve apo konkurset e zhvilluara deri më tani nga organizata të ndryshme, me mbështetjen dhe të partnerëve privatë, kanë demonstruar se ka një numër të konsiderueshëm të rinjsh të interesuar të jenë pjesë e këtyre iniciativave të cilat ofrojnë mundësi punësimi për të rinjtë ose mentorim për ngritjen e startup-eve nga ata.

[Duke iu referuar Renditjes Globale së Ekosistemeve të Startup-eve për vitin 2020, Shqipëria u ngrit me 13 vende nga renditja e një viti më parë, ndërsa Tirana, e cila kohët e fundit është shndërruar në qytet miqësor për startup-et, u rrit me 53 vende krahasuar me 1 vit më parë.](#)

Pra shihet se pavarësisht një periudhe stanjacioni (deri para vitit 2017) sektori i startup-eve në Shqipëri, në dy vitet e fundit, ka përjetuar një zhvillim të konsiderueshëm nëpërmjet zhvillimit të disa aktiviteteve dhe iniciativave, si organizimi i trajnimeve, këshillimeve lidhur me ngritjen e një startup-i, organizimin e Hackathon-ëve (evente ku të rinjtë garojnë me idetë e tyre për t'i dhënë

1. Analiza është bazuar në vlerësimin e arritjeve të deritanishme të raportuara në takimet rajonale nga vendet e BP-së apo në raportet e vlerësimit të hartuara nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Sekretariati i CEFTA-s, para Samiteve Rajonale, të organizuara në kuadër të procesit të Berlinit.

zgjdhje një problematike aktuale), ngritja e inkubatorëve dhe akseleratorëve, etj. Megjithëse viti 2018 nuk do të klasifikohet si një nga vitet më të mira për sa i përket startup-eve, zhvillimi i ekosistemit ishte në aktivitet të plotë për shkak të një interesi të shtuar nga sektori privat dhe publik. Korporatat e institucionet financiare, të tilla si Kfw, Raiffeisen, Pro Credit Bank, NoA, institucione si Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Arsimit si dhe ambasada dhe organizata të ndryshme të huaja ndërmorën një sërë aktivitetesh të ndryshme mbështetëse që synonin zhvillimin e ekosistemit. Këto iniciativa arritën të rrisnin ndërgjegjësimin e të rinjve në përgjithësi me objektiva afatshkurtra dhe afatmesme të ofrimit të financimit të drejtpërdrejtë për startup-et potenciale (Startups Europe Netëork). Gjithsesi, duke qenë se këto iniciativa ishin kryesisht të shpërndara në sektorë dhe aktorë të ndryshëm, impakti i tyre nuk arriti të ishte i ndjeshëm a duhej në zhvillimin e ekosistemit në tërësi.

Në fund të vitit 2018 dhe gjatë vitit 2019, një numër iniciativash të reja u zhvilluan si Officina, Pro-Tick Center, ICT Lab, Invest Albania, Uplift, Innospace, Women Founders Network, Coolab, Innvest, etj që kanë inkurajuar dhe mbështetur zhvillimin e startup-eve.

- Por edhe pse këto zhvillime kanë rezultuar pozitive, mbeten ende shumë sfida për t'u kapërcyer. Së pari, është e rëndësishme që sektori privat të përfshihet më shumë duke bërë të mundur krijimin e lidhjeve organike midis tyre, startup-eve të reja dhe universiteteve. Kjo do të sillte një integrim më të mirë të nevojave të tregut me aftësitë ekzistuese, si dhe do të jepte orientimin e duhur për aftësitë që duhet ene të zhvillohen tek të rinjtë, ku rolin kryesor e ka universiteti.
- Së dyti, zhvillimi i ekosistemit për mbështetjen e startup-eve në Shqipëri ka qenë relativisht i ngadaltë deri më tani dhe është karakterizuar nga stimuj ad hoc të cilët, duke qënë të fragmentuar, jo gjithmonë kanë arritur të kenë impaktin e dëshiruar në ekosistem.
- Së treti, shumica e organizatave mbështetëse për startup-et janë përqendruar në Tiranë. Jashtë Tiranës, iniciativat për të ngritur akseleratorë ose inkubatorë janë akoma në fazat e tyre fillestare, me përjashtime të vogla për disa rajone si Korça dhe Shkodra. Për më tepër, organizatat

mbështetëse shqiptare po luftojnë të gjitha për një pjesë shumë të vogël të tregut të start-upeve dhe janë përqendruar në mënyrë disproporcionale në mbijetesën e tyre sesa në ndihmën ndaj startup-eve.

Gjatë viteve, Shqipëria ka marrë ndihmë financiare nga donatorë të ndryshëm, por shumica e tyre është përqendruar më shumë në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe në promovimin e punësimit sesa në promovimin e inovacionit të startup-eve. Duke mos pasur koordinim, këto projekte nuk kanë çuar në struktura afatgjata të qëndrueshme, por thjesht kanë mbajtur ofruesit e shërbimeve në biznes.

Me fjalë të tjera, ekosistemi i startup-eve në Shqipëri mund të përshkruhet si i "porsalindur", ku shumica e aktiviteteve dhe nismave janë në fazën e rritjes së ndërgjegjësimit, e cila mund të definohet si faza "Informim & Frymëzim". Sidomos jashtë Tiranës ekosistemi i startup-eve mbetet i pazhvilluar. Për të konkurruar me partnerët rajonalë dhe ekosistemin evropian të startup-eve, është thelbësore që ekosistemi Shqiptar të zhvillohet më tej dhe të kalojë në fazën "Zgjim & Manifestim" ku idetë inovative fillojnë të materializohen në ide të mirëfillta biznesi.

Megjithëse shpesh theksohet se tregjet relativisht të vogla, si Shqipëria, nuk ofrojnë mundësi të mjaftueshme për startup-e, vlen për t'u përmendur se disa vende të vogla si Zvicra, Izraeli, si dhe vendet e Evropës Lindore kanë treguar rezultate të mira në nivel global në aspektin e ekosistemit dhe ndërmarrjeve të reja si startup-et. Sipas ["The Global Entrepreneurship Index \(GEI, 2019\), Zvicra renditet në vendin e 2-të midis vendeve të tjera, me një rezultat 80.4, më të lartë se në vitin 2018. Izraeli zë vendin e 12-të midis 15 vendeve më të mira dhe shënon 67.9.](#)

Ekosistemi shqiptar ofron një sërë faktorësh pozitivë që mund të ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm të tij. Për më tepër, të rinjtë shqiptarë janë multilingual. Përveç anglishtes, një shumicë flet italisht, anglisht, greqisht dhe gjuhë të tjera evropiane për shkak të numrit të lartë të të diplomuarve jashtë vendit, si dhe historisë së migrimit të familjeve të tyre. Për më tepër, ekziston një numër i lartë i shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit dhe remitancat e tyre kanë një kontribut të rëndësishëm në ekonominë shqiptare. Gjatë periudhës së emergjencës së COVID-19, u pa

një interes i madh i shqiptarëve të diasporës për të kontribuar dhe mbështetur vendin e tyre. Ky fakt dëshmon se duhen intensifikuar përpjekjet për të shfrytëzuar këtë potencial të madh të "Trurit Shqiptar" jashtë vendit si dhe të krijohet terreni i duhur për më shumë bashkëpunim me ta në të ardhmen. Shumica e tyre kanë familjet e tyre si dhe një pozitë të mire e të qëndrueshme jashtë territorit të Shqipërisë, kështu që do të ishte shumë e vështirë për t'i tërhequr ata në Shqipëri. Kjo tregohet edhe me programet e mëparshme të Brain Gain (thithja e trurit) që nuk arritën objektivin e tyre final, pasi është e vështirë të kërkosh që këto asete të mira të kthehen në Shqipëri pa patur terrenin e duhur për t'i pritur por edhe pa krijuar rrjetin dhe premiset e nevojshme për ta bërë atë. Sidoqoftë, ekziston një mundësi e mirë për të përdorur këtë kapital njerëzor, pra njohuritë, fondet si dhe përvojën e diasporës, për të zhvilluar më tej ekosistemin e startup-eve në Shqipëri.

Palët kryesore të interesit

[Sipas raportit të fundit "Ekosistemi Sipërmarrës dhe Inovacioni në Shqipëri", botuar në Nëntor të vitit 2019 nga Projekti "EU for Innovation, ekziston një larmi aktorësh të ndarë në pesë grupe kryesore si më poshtë:](#)

1. **Politikbërësit ku përfshihen institucionet dhe agjencitë qeveritare, të tilla si:** Kryeministria, Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia e Tiranës, AIDA, AKKSHI, etj)

Roli i politikbërësve është thelbësor për sa i përket hartimit të legjislacionit me synim heqjen e pengesave për financimin e start-upeve si dhe rritjen e tyre, veçanërisht në fusha si: zhvillimi i një politike të zbatueshme, rregullimi i sferës konkurruese, taksimi i drejtë etj., si dhe ofrimi i mundësive dhe kushteve që startup-et të lulëzojnë dhe të rriten në të ardhmen. Ato kanë rol kyç për të lehtësuar operatorët ekonomikë që të veprojnë normalisht në tregun e punës.

2. **Organizatata mbështetëse ku përfshihen Shoqatat / Dhomat (Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, Bashkimi i Prodhuesve, TIK Shqiptar), Ofruesit e Shërbimeve (Agjencia**

e Zhvillimit Rajonal, Protik, Swiss Contact), Donatorët (Qeveria Gjermane, USAID, UNDP, Swiss, AADF, Sida), Inkubatorët / Përsheptuesit / Co-working (TechSpace, Officina, Yunus Social Business, UK-Albania TechHub, Uplift, Innospace, Coolab, Tirana Talent Garden, Albanian Innovation Accelerator, MetroResearch Center at MTU), Events / Community (Startup Grind, Garazhdi, Open Lab, Startup Weekend Tirana, Summer School GOA, Albanian ICT Awards, Innovate, TEDx Tirana, InfoCOM, etj), Portalet / Regjistrat (Innovation Map, Invest in Albania, etj)

Për startup-et, këto rrjete peer-to-peer të ngritura në TechSpace Officina, UK-Albania TechHub, Garazhdi, Officina, Coolab, etj. janë të një rëndësie të konsiderueshme pasi aty të rinjtë mund të mësojnë nga përvojat e njëri-tjetrit. Organizatat mbështetëse synojnë të këshillojnë dhe udhëheqin startup-et për të zhvilluar dhe forcuar biznesin e tyre, duke i dhënë mundësinë për të përfituar dhe nga mentorime personale, pjesëmarrje në forume ku mund të marrin përvojë nga startup-e të suksesshme si dhe hapësira ku mund të zhvillohen, inkubojnë dhe mbështesin financiarisht idetë e tyre.

3. **Kapitali Njerëzor përfshirë Universitetet Publike dhe Private (Universiteti i Tiranës. Universiteti i Arteve, Universiteti Bujqësor, Universiteti Politeknik, Universiteti Mjekësor i Tiranës, Universiteti European i Tiranës, Marin Barleti, Universiteti i Biznesit i Tiranës, Universiteti Polis, Universiteti Luarasi, Universiteti Metropolitan, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë etj.), Organet dhe shoqatat shkencore (Akademia e Shkencave, Akademia Shqiptare e Artit dhe Shkencave, Shoqata e Grave Shqiptare në Shkencë (themeluar me mbështetjen e UNESCO-s dhe mbështetur nga Qendra Rajonale e Zhvillimit të Qëndrueshëm) dhe Nisma Studentore (Epoka Innovators Lab, etj).**

Kapitali njerëzor luan një rol vendimtar edhe pse zakonisht neglizhohet nga shumica e sipërmarrësve. Kapitali njerëzor konsiderohet si energjia e nevojshme për të çuar përpara çdo biznes ose për të filluar një kompani apo start-up. Rekrutimi i njerëzve të talentuar nuk është një opsion, por një hap vendimtar për drejtimin e një startup-i të suksesshëm, sepse

janë këta njerëz që do të kontribuojnë me njohuritë, angazhimin, përvojën dhe motivimin e tyre për t'u rritur dhe pasuruar më tej. Për më tepër, universitetet mund të konsiderohen si aktorët kryesorë kur flitet për fazën e para-ideimit, nga ku fillon dhe udhëtimi drejt qasjes sipërmarrëse. Universitetet gjithashtu mund të mbështesin sipërmarrësit e rinj që lulëzojnë në fazën e ideimit, duke i ndihmuar me inkubacion, por gjithsesi kjo varet nga institucioni dhe rëndësia që ai i jep sipërmarrjes. Është shumë e rëndësishme të integrohet një "mision i ri", në misionin kryesor të universitetit, për të kontribuar në zhvillimin e kulturës sipërmarrëse, që shkon përtej mësimdhënies dhe ky mund të konsiderohet si një rol themelor i universiteteve. Përfshirja e Kapitalit Njerëzor nga diaspora përmes nismave dhe mjeteve të ndryshme do të jetë gjithashtu thelbësore për mbështetjen e sipërmarrjes dhe ekosistemit në Shqipëri.

4. Sektori privat i cili mbulon të gjitha kompanitë si *ProCredit, EasyPay, Balfin Group, Vodafone Foundation, etj.*

Sektori privat, përveç faktit se është motori që nxit rritjen, investimet, krijimin e vendeve të punës, pagesën e taksave, është gjithashtu mjedisi ku lindin dhe lulëzojnë idetë e inovacionit. Kjo është arsyeja pse lulëzimi i startup-ve dhe inovacionit ndodh në ato vende të botës si SHBA, Anglia, Gjermania, etj. që kanë sektor privat të shëndetshëm dhe të zhvilluar mirë.

5. Media përfshirë Portalet dhe modelet si TedEX ose Start up grind, etj.

Media po kthehet në një mundësi mjaft të mirë marketingu dhe roli i saj po rritet dita ditës. Në fakt mediat sociale si Facebook-u, Twitter-i dhe Instagram-i janë bërë pjesë integrale e shpërndarjes së përmbajtjes dhe ndërgjegjësimit të markës me strategjitë e blerjes së klientëve për të gjitha bizneset përfshirë dhe startup-et.

6. Institucionet Financiare, përfshirë Bankat / Institucionet Monetare Financiare (*Raiffeisen, Fondi Besa, FED Invest, etj.*), *Dhe fondet (Crimson Fund Fund, Sida EU for Innovation Challenge Fund, etj)*

Krijimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i një startup-i nuk mund të imagjinohet pa mbështetjen e organizatave

financuese. Disa nga këto organizata, të cilat luajnë një rol vendimtar në vitalizimin e start-upeve, veçanërisht në segmentin financiar, janë Bankat ose institucionet e tjera financiare. Ata ofrojnë fonde përmes huave për startup-et dhe krijojnë programe speciale të mbështetjes, të cilat shpesh përfshijnë programe mentorimi. Ndër vite, këto institucione financiare po përpiqen të japin sa më shumë mbështetje e lehtësime për zhvillimin e startup-eve. At ofrojnë fonde përmes huave për startup-et dhe krijojnë programe speciale të mbështetjes, të cilat shpesh përfshijnë programe mentorimi.

Nismat të tjera të qeverisë lidhur me rininë, ekosistemin e startup-eve dhe sipërmarrjen

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë vjen si pjesë e Programit Qeveritar për Rininë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Strategjisë Rinore të Bashkimit Evropian dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Rajonale të EJK (2014-2020) po shënon një pikë kthese të rëndësishme në mënyrën se si politikat qeveritare angazhohen për të ndikuar dhe ndihmuar të rinjtë. [Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 përfaqëson kështu dokumentin themelor që koordinon dhe siguron zbatimin e politikave ndër-sektoriale për të rinjtë, duke filluar nga punësimi dhe arsimit, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, kultura, sportet dhe vullnetarizmi, dhe veçanërisht, rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në demokraci e në proceset e vendimmarrjes politike.](#)

Të rinjtë përmenden gjithashtu, por jo të kategorizuar në mënyrë specifike, si një grup fokal në strategji të tjera të rëndësishme si Plani Kombëtar i Veprimit për LGBTI 2016-2020 ose [Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020](#). Të dy strategjitë përfshijnë përmirësimin e kurrikulës shkollore për të rinjtë. [Gjithashtu, çështje të tilla si punësimi i të rinjve dhe arsimit profesional janë çështje që adresohen dhe në Strategjinë e Punësimit dhe Aftësive 2013-2020.](#)

Megjithëse Shqipëria nuk ka një strategji kombëtare për startup-et, koncepti i startup-eve është pjesë e një strategjie më të gjerë. Startup-et përmenden në një mënyrë apo një tjetër në strategjitë për NVM-të, ose strategjitë e zhvillimit të investimeve, si dhe në dy strategjitë që mbështesin inovacionin: [Strategjinë](#)

Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2009-2015 dhe Strategjinë ndërsektoriale "**Agjenda Digjitale për Shqipërinë 2015-2020**", [por deri më tani nuk ka patur ndonjë dokument strategjik specifik për to.](#)

Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin u përqëndrua në mbështetjen e qendrave të ekselencës, ndërtimin e qendrave të reja të ekselencës në sektorët e kërkimit/hulumtimit dhe inovacionit që gjithashtu tërheqin aktorë të rëndësishëm të fushës shkencore. Një tjetër synim i kësaj strategjie ishte rritja e shpenzimeve publike për kërkimin e zhvillimin, shpërndarjen e inovacionit në biznese dhe organizata, krijimin e mundësive për t'u integruar me homologët evropianë dhe njohjen zyrtare të rëndësisë së inovacionit në Shqipëri. Ndërsa Agjenda Digjitale për Shqipërinë 2015-2020 parashikon krijimin e qendrave të inovacionit TIK (Teknologjise së Informacionit dhe Komunikimit), një objektivi që është arritur në pjesën më të madhe, por është me kapacitete ende të kufizuara. Në nivel qeveritar, plani i veprimit për Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (2014-2020) përfshin një numër aktivitete në lidhje me start-upet dhe sipërmarrjen, ku disa prej tyre janë përfshirë në paragrafin në vijim ([MFC, 2017](#)):

- Krijimi i mundësive për punë të denja përmes nxitjes së politikave efektive në tregun e punës.
 - Identifikimi në mënyrë specifike i të rinjve. Femra dhe meshkuj të cilët janë të papunë dhe në kërkim të një punë, dhe që në të ardhmen mund të jenë sipërmarrës të mundshëm.
 - Krijimi i programeve për startup-e për sipërmarrësit potencialë të rinj. Femra dhe meshkuj për të mbështetur vetëpunësimin e tyre.
- Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit.
 - Promovimi i të mësuarit rreth sipërmarrjes si dhe përqendrimi i vëmendjes tek sipërmarrja e grave si një kompetencë kryesore.
 - Zhvillimi dhe zbatimi i programeve specifike për ndërmarrje të krijuara për qëllime specifike dhe që targetojnë grupe të vecanta, duke synuar të ndihmojnë posaçërisht vajzat dhe gratë, përfshirë dhe zonat rurale.

- Zhvillimi dhe zbatimi i programeve lidhur me aftësitë e lidhshme dhe aftësitë menaxheriale që targetojnë vecanërisht gratë dhe vajzat.
- Nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial.
 - Nxitja e sipërmarrjes sociale (ekonomia sociale dhe punët e sektorit të tretë) dhe fuqizimit ekonomik të grave.
 - Krijimi i strategjive gjithëpërfshirëse për start-upet duke përfshirë konsulencën one-stop, si dhe një vlerësim profesional (nga profesionistë të fushës) të ideve fillestare të biznesit
 - Përgatitja e modaliteteve, si dhe hartimi i masave të përshtatshme dhe me ndjeshmëri për çështjet gjinore, për klientët në përgatitjen e start-upeve, si dhe këshillimi i vazhdueshëm të paktën gjatë vitit të parë të vetë-punësimit.
 - Kurse bazike dhe praktike për zhvillimin e aftësive të biznesit në menaxhim, marketing, përdorim të teknologjisë, shtim të vlerës, ndërtim biznesi dhe start-ups të ofruara veçanërisht për gratë dhe vajzat dhe specifikisht në zonat rurale.
 - Krijimi i lidhjeve ndërmjet kurseve bazike-teorike dhe atyre praktike lidhur me rritjen e aftësive në biznes, me programe të veçanta që mbështesin grupe biznesesh të drejtuara nga gratë si dhe start-upe.
 - Zhvillimi i programeve speciale për mbështetjen e grupeve të biznesit të drejtuara nga gratë si dhe start-upe, përfshirë zonat rurale.
 - Kryerja e një studimi mbi gratë dhe vajzat që përfitojnë nga masat / programet në lidhje me sipërmarrjen sociale dhe fuqizimin ekonomik të grave, përfshirë këtu dhe zonat rurale.

Megjithëse konkurrenca ndërmjet bizneseve shqiptare është përmirësuar nga viti në vit, një objektivi i rëndësishëm mbetet rritja e mëtejshme e konkurrencës në të gjithë sferën ekonomike.

Strategjia e Specializimit Inteligjent (S3), është një strategji që parashikohet të finalizohet deri në vitin 2022. S3 është një strategji me një qasje drejt inovacionit, e cila u konceptua si një iniciativë "Made in the EU" lidhur me politikën e kohezionit Evropian. Ajo karakterizohet nga identifikimi i sektorëve prioritarë dhe zonave strategjike që kanë nevojë për ndërhyrje, bazuar në analizën e pikave të forta dhe

potencialeve të ekonomisë dhe në një Proces të Zbulimit të Sipërmarrjes (EDP) me përfshirje të gjerë të palëve të interesit, kryesisht nga industria dhe sektori privat. Kjo strategji përqafon një pamje të gjerë të inovacionit, duke përfshirë qasjet e orientuara drejt teknologjisë, si dhe të mbështetura në mekanizmat efektivë të monitorimit. S3 do t'i do të përforcojë/promovojë politikat e inovacionit duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri. Strategjia e Specializimit Inteligjent është një qasje inovative që synon të nxisë rritjen dhe vendet e punës në Evropë, duke mundësuar secilin rajon e vend të identifikojë dhe zhvillojë avantazhet e veta konkurruese. Përmes partneritetit dhe qasjes së kësaj strategjie nga poshtë-lart, specializimi inteligjent bashkon autoritetet lokale, akademinë, sektorin privat dhe shoqërinë civile, për të punuar për zbatimimin dhe implementimin e strategjive afatgjata të zhvillimit të mbështetura gjithashtu nga fondet e BE-së. Inovacioni lidhet drejtperdrejtë me të rinjtë, dhe një strategji e tillë do ndihmojë Shqipërinë dhe rininë shqiptare në rrugën drejt integritimit Evropian.

Konkluzione dhe rekomandime

Ekosistemet dinamike dhe të qëndrueshme të startup-eve nëpërmjet promovimit të përdorimit të teknologjisë dhe inovacioneve, mund të çojnë në krijimin e startup-ve të reja që më pas çojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, tërheqin talentet ndërkombëtare, si dhe investimet e huaja direkte, duke siguruar kështu stimul për rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë në të gjithë vendin.

Që ekosistemi i startup-eve të jetë i qëndrueshëm dhe të ketë rritje në planin afatgjatë, qëllimet dhe objektivat duhet të vendosen në bashkëpunim me sektorin publik dhe privat, dhe duhet të zbatohen duke përdorur një qasje nga poshtë-lart, si dhe të përqafohen nga të gjithë, në mënyrë që ky ekosistem të jetë i suksesshëm. Gjithashtu, duhet të ketë një lidhje organike midis aktorëve të ndryshëm të ekosistemit (të tilla si investitorët, universitetet, korporatat, startup-et, qeveria, teknologjia, inovacioni dhe qendrat e shkencës, etj). Me pak fjalë, nevoja për ngritjen e një ekosistemi për startup-et duhet të vijë nga komuniteti dhe sektori privat, megjithatë, sektori publik dhe

strukturat qeveritare janë thelbësore për të mbështetur ekosistemin kryesisht në fazën shumë të hershme për ta nxitur atë të zhvillohet në drejtimin e duhur në linjë dhe me prioritetet ekonomike të vendit. Siç tregojnë të dhënat statistikore, krijimi i vendeve të reja të punës në shqipëri mbetet ende sfidues. Si rezultat, është e nevojshme një lidhje e qëndrueshme midis qeverisë dhe sektorit privat për të adresuar çështjen e papunësisë. Krijimi i instrumenteve mbështetëse për promovimin e sipërmarrjes dhe inovacionit mund të jetë një rrugëdalje për të përmirësuar në një farë mënyre shkallën e papunësisë së të rinjve. Ka ardhur koha që vendi të përqendrohet më shumë në sferën e inovacionit, dixhitalizimit, si dhe në promovimin e krijimit të sipërmarrjeve të reja, si start-upet apo edhe NVM-të. Rritja e qasjes ndaj sipërmarrjes dhe krijimi i start-upeve, konsiderohet si një mundësi e vlefshme karriere për brezat e rinj dhe gjithashtu mund të jetë një zgjidhje e shkëlqyeshme jo vetëm për punësimin e të rinjve, por edhe në drejtim të diversifikimit të tregut drejt produkteve dhe shërbimeve më digjitale e inovative. Për më tepër është e rëndësishme të zhvillohen dhe të përdoren aftësitë digjitale lidhur me punësimin dhe sipërmarrjen. Është e nevojshme që të parashikohet sot se cilat aftësi do të nevojiten në të ardhmen, në mënyrë që të trajtohen të rinjtë sot, në këtë drejtim dhe në përputhje me nevojat e nesërme të tregut të punës.

Më poshtë paraqiten disa rekomandime specifike për t'u marrë në konsideratë në lidhje me zhvillimin e ekosistemit të startup-eve dhe mjedisit sipërmarrës kryesisht me fokus të rinjtë, në Shqipëri:

- **Ndërtimi i themeleve për një ekosistem të qëndrueshëm të startup-eve dhe nxitja e inovacionit**

Për të nxitur dhe lehtësuar inovacionin dhe sipërmarrjen e re, duhet të ketë një infrastrukturë të zhvilluar mirë në gjendje të krijojë lidhje dhe sinergji midis sipërmarrësve të rinj, investitorëve (p.sh. inkubatorët, rrjetet e engjëjve të biznesit, përshpejtuesit) dhe sektorit publik.

- **Aksesi në talent dhe rritja e ndërgjegjësimit për ekosistemin**

Është thelbësore që vëmendja të përqendrohet në organizata të ndryshme dhe aktorë të ekosistemit që ofrojnë veprimtari edukuese dhe kontribuojnë në

ndërtimin e kapaciteteve.

- Zhvillimi i talentit lokal nëpërmjet mbështetjes së njësive arsimore dhe lëvizja drejt kulturës së të mësuarit rreth sipërmarrjes që çon në inovacion.
- Përthithja e talentit ndërkombëtar dhe ekspertizës së huaj nëpërmjet promovimit të ekosistemit shqiptar të startup-eve në nivel ndërkombëtar.
- Përmirësimi i politikave të taksimit.
- Edukimi i shoqërisë në përgjithësi për startup-et dhe vlerën që ato mund t'i sjellin rritjes ekonomike të të gjithë vendit

- **Ndërtimi i kapaciteteve dhe forcimi i marrëdhënieve bashkëpunuese ndërmjet aktorëve të ekosistemit**

Në një botë digjitale si kjo e sotmja, që ekonomia të ecë përpara dhe të jetë konkurruese midis vendeve të tjera, është thelbësore që të nxiten dhe forcohen marrëdhëniet e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm të ekosistemit fillestar – startup-eve, hapësirave të bashkëpunimit, inkubatorëve, përshpejtuesve, investitorëve individualë dhe institucionalë, korporatave private, sektorit akademik dhe publik.

- Krijimi i një rrjeti më të fortë – mbështetja dhe krijimi i mundësive të rrjetëzimit midis aktorëve të ndryshëm të ekosistemit të startup-eve dhe inovacionit për të siguruar harmonizimin e aktiviteteve dhe për të nxitur rritjen më të shpejtë të ekosistemit.
- Ndërtimi i kapaciteteve të aktorëve të

ekosistemit të startup-eve dhe inovacionit - për të siguruar rritje të qëndrueshme dhe zhvillim të ekosistemit, të gjithë palët e interesuara duhet të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe të promovojnë shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare.

- **Aksesi në Financa**

Financimi i kapitalit është një nga format më të përshtatshme të financimit për fazat e hershme të startup-eve, dhe në shumë raste, është e vetmja formë në dispozicion të të rinjve që fillojnë një sipërmarrje të tyre, pasi shumica e opsioneve tradicionale të financimit (të tilla si huatë bankare ose garancitë) kërkojnë kolateral të arsyeshëm i cili nuk është në dispozicion të themeluesve të startup-eve.

- **Kuadri ligjor** - Përmirësimi i legjislacionit dhe regjistrimit për investitorët, fondet e investimeve për të lehtësuar krijimin e kapitalit sipërmarrës dhe fondeve të investimeve;
- Tërheqja e përfitimeve smart – krijimi i mundësive të ndryshme për të përthithur njohuri dhe përvojë ndërkombëtare, pasi startup-et në fazën e hershme varen më shumë nga njohuritë sesa thjesht nga mbështetja e pastër financiare;
- Ndërtimi i rrjetit të engjëjve të biznesit – krijimi i një organizate ombrellë për engjëjt e biznesit dhe grupet e engjëjve të biznesit që kërkojnë mundësi investimi në Shqipëri me qëllim rritjen e sasisë dhe cilësisë së investimeve / startup-eve lokale në fazën fillestare, të cilat më pas mund të kthehen në ide të suksesshme biznesi.